

C.nr.265/2012

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE (ne objektin e Deges se kesaj Gjykate ne Vushtri) gjyqtari Skender Shala, ne çeshtjen juridike te paditesve
 nga _____ qe te gjithe nga _____ te cilet i perfaqeson avokati _____ sipas autorizimit me shkrim, kunder te paditurve _____ nga _____ tani me vendbanim te panjohur, te cilin e perfaqeson perfaqesuesi i perkohshem avokati _____ nga _____ sipas aktvendimit te kesaj gjykate dhe _____ nga _____ per vertetim pronesie, vlere e kontestit 800,00 Euro, pas mbajtjes se shqyrtimit kryesor dhe public te dt.16.04.2015, me dt. 24.04.2015, bie kete:

AKT GJYKIM

I – APROVOHET kerkespadia e paditsve dhe **VERTETOHET** me sa vijon:

- Paditesi _____ nga _____ eshte pronar i paluejtshmerise , pjeses se parceles katastrale _____ me kultur peme e klases III, ne vendin e quajtur „ _____ , me masat dhe kufijt qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes, ne sipërfaqe prej **S=397m²** dhe parceles katastrale nr. _____ me kulture pemishte , klases IV, ne vendin e quajtur _____ me masa dhe kufijt qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes, ne sipërfaqe **S=87 m²**, te gjitha keto sipas certifikates se pronesise qe evidentohet ne emer te paditurit

- Paditesi _____ nga _____ eshte pronar i paluejtshmerise , pjeses se parceles katastrale nr. _____ me kultur vreshte e klases II, ne vendin e quajtur „ _____ , me masat dhe kufijt qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes, ne sipërfaqe prej **S=269m²** dhe pjesen e parceles katastrale nr. _____ me kulture peme , klases III, ne vendin e quajtur _____ me masa dhe kufijt qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes, ne sipërfaqe **S=113 m²**, te gjitha keto sipas certifikatve se pronesise qe evidentohen ne emer te te paditurve _____ 1/1 ZK Mitrovice – Veri dhe _____ ZK Mitrovice – Veri.

- Paditesi _____ nga Mitrovica eshte pronar i paluejtshmerise , pjeses se parceles katastrale nr. **2735-1**, me kultur vreshte e klases II, ne vendin e quajtur „ Kukavica ”, me masat dhe kufijt qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes, ne sipërfaqe prej **S=540 m²** dhe pjesen e parceles katastrale nr _____ me kulture peme , klases III, ne vendin e quajtur _____ me masa dhe kufijt qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes, ne sipërfaqe **S=304 m²**, te gjitha keto sipas certifikatve se pronesise qe evidentohen ne emer te te paditurve _____ - Veri dhe _____ (Maksim)



- Paditesi nga Mitrovica eshte pronar i paluejtshmerise , pjeses se parceles katastrale nr. , me kultur vreshte e klases II, ne vendin e quajtur „ Kukavica ”, me masat dhe kufijt qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes, ne sipërfaqe prej **S=595 m²** dhe pjesen e parceles katastrale nr. me culture peme , klases III, ne vendin e quajtur “Kukavica” me masa dhe kufijt qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes ne sipërfaqe **S=53 m²**, te gjitha keto sipas certifikatve se pronesise qe evidentohen ne emer te te paditurve . – Veri dhe

II – OBLIGOHEN te paditurit qe t’ua njohin kete te drejte paditesve dhe ti lejojne qe paditesit kete paluajtshmeri ta regjistrojne ne emer te tyre, ne librat e tokes te Zyra Kadastrale Komunale ne Mitrovicë, ne afatin prej 15 (pesembedhjet) diteve, nga dita e pranimit te ketij aktgjykimi.

Secila pale i barte shpenzimet e veta te procedures kontestimore.

A r s y e t i m

Paditesit ne padin e tyre te parashtruar si dhe nepermjet te autorizuarit te tyre ne seancat e mbajtura kane theksuar se paraardhesit e tyre (baballaret) gjate viteve 70-ta, ne baze te marveshjes gojore, e kan blere nga te paditurit paluajtshmerit e cekur si ne dispozitiv e te cilen cmim ia kane paguar shitesve – tani te paditurve ne teresi dhe qe nga momenti i shitblerjes te njejtit se bashku me familjet e tyre kane hyre ne posedim te pronave, ku ne vazhdimesi e kane shfrytëzuar pa asnje lloj kufizimi apo pengese. Paditesit tani vone e kane kuptuar qe paluajtshmeria e cila eshte ne posedim faktik te tyre qe nga blerja e saj mbi 40 vite nuk evidentohet ne emrin e tyre, andaj, kane interes juridik qe kjo paluajtshmeri edhe juridikisht te evidentohet ne emrin e tyre.

Pasi qe i padituri eshte ne adrese te panjohur i propozuan gjykates qe t’ia caktoi perfaqesuesin e perkohshem.

I autorizuari i paditesit ne seancen e shqyrtimit kryesor beri precizimin e kerkesapdise sa I perket sipërfaqes , shtrirjes dhe perkufizimit te paluajtshmerise dhe ate sipas konstatimit dhe mendimit te ekspertiit gjeodet e edhe sa I perket te te paditureve si ne ekspertize. Ne fjalen e tij perfundimtare theksoi se nga administrimi I te gjitha provave te propozuar ne menyre te drejte dhe korrekte nga ana e kesaj gjykate u vertetua ne teresi baza juridike e kerkesapdise se paditesve gjegjesisht fakti se paditesit jane pronare te paluajtshmerive tani lendore dhe ate secili ne pjesen e vet te paluajtshmerise sipas ekspertizes perkatese te ekspertit gjeodet.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoi.



Ne baze te propozimit te autorizuarit te paditesit e konform nenit 79.1.3/a dhe 81.1 te LPK-es, gjykata me aktvendimin C.nr.265/2012 te dt.01.04.2014, te paditurit ia caktoi Perfaqesuesin e perkohshem, av. , i cili ne baze te ketij aktvendimi do t'i ushtroni te drejtat dhe detyrimet, konform nenit 82.1.2 te LPK-es.

Perfaqesuesi i perkohshem i te paditurit ne pergjigje te padise dhe precizimit te kerkespadise te paditesit ne shqyrtimin kryesor dhe ne fjalen perfundimtare Gjykates I propozoj qe conform rrezultatit te provave ne proceduren provuese te bie vendim meritor lidhur me kete ceshtje juridike-civile.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoi.

Gjykata seancen e shqyrtimit kryesor e mbajti ne mungese te te paditures Hyrije Kamberaj, conform nenit 423.4 te LPK.

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesor, zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme dhe pas administrimit dhe vlersimit te te njejtave ne kuptim te nenit 8 te LPK-es, erdhi ne perfundim se duhet vendosur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi nga keto arsye.

Gjykata ne proceduren e provave lexoi: cartifikatat mbi pronesin te dt.05.12.2014, ZK Mitrovica, ne emer te te paditurit dhe te dt. 22.04.2014, ne emer te te paditures Hyrije Kamberaj, Procesverbalin mbi vendshiqimit C.nr.265/12 te dt. 16.04.2014, ekspertizat e ekspertit gjeodet I dt. 12.05.2014, beri veshrtim ne skicen e terenit dhe ne kopien e planit nga I njejtj ekspert gjeodet, ndegjoi deshmitaret l dhe qe te dy nga Mitrovica dhe konstatoi kete gjendje faktike:

Nga cartifikatat e pronesise te cekura me lart, konstatohet se pjeset e parcelave katastrale nr. evidentohe ne emer te te paditurve dhe parcela katastrale evidentohe ne emer te te paditurit te pare.

Nga konstatimi dhe mendimi i ekspertit gjeodet te cekur me lart, konstatohet se pas matjeve te kryera te pjeseve te paluajtshmerise nga ana e ekspertit gjeodet dhe ne baze te dokumentacionit, me te cilin posedon per momentin Drejtoria e Gjeodezise dhe Kadastrit ne Mitrovica, ka vertetuar se pjeset e paluajtshmerive dhe paluajtshmeria kontestuese bien – gjegjesisht e perbejne pjeset e parcelve te cekura me larte me masa dhe kufij te shenuara si ne ekspertizen e dhene me shkrim dhe ne skicen e terenit, e cilat jane pjese perberse te ketyre ekspertizave dhe te aprovuara si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Nga procesverbali mbi vendeshiqimin i kesaj gjykate te cekur me larte konstatohet se gjyqtari me vrojtim te drejtperdrejte ne vend konstatoi se paluajtshmerija kontestuese eshte e kufizuar ne te gjitha anet me prone private. Ne te jane te ndertuara dy shtepi , njera (P+1) e ndertuar ne vitin 1970 dhe tjetra shtepi njekateshe e ndertuar ne vitet 80-ta sipas ekspertit gjeodet ne vendshiqim.



Deshmitari [] deklaroi se ai personalisht e din se paraardhesit e paditesve dhe [] (baballaret e paditesve) e kan blere ne vitin 1971 paluajteshmerine nga shitesi [] me emrin te shitblerjes prej 1000 banka te atehershem per nje ari ne siperfaqe prej rreth 32 ari, . E di mire dhe me kujtohet se te njejtia ia kan ka paguar te hollat ne teresi shitesit [] E di se me rastin e shitblerjes nuk kane perpiluar ndonje kontrate me shkrim por jane marre vesh ne menyre gojore. Me rastin e shitblerjes ne ate paluajteshmeri nuk ka pas shtepi te ndertuar por mas nje viti I kane ndertuar shtepiat nje kateshe. E di se prej momentit te blerjes kan hyr ne perdorim dhe posedim te ajo patundeshmerie . Dhe per sa e di une prej momentit e shitblerjes e kan shfrytezuar pa kurrfar pengesash dhe protestash nga personat tjere ne menyre te ligjshme. Keto rrethana me jane te njohura sepse une kam jetuar ne fqinjesi me baballaret e paditesve e me pastaj edhe me paditesit.

Deshmitari [] deklaroi se ai personalisht e din se paditesit e kan blere ne vitin 1971 nga shitesi me emrin [] , ateher e kemi quajttur si lagje e [] dhe me kujtohet shume mire kur babai im na ka pas treguar se familja e [] (familjet e paditesve) e blejten token nga [] ne emrin te shitblerjes prej 1.000.000 dinar te atehershem, per tere paluajteshmerin, ne siperfaqe prej rreth 30 ari, dhe e di se te hollat ia kane paguar ne teresi shitesit. Nuk me kujtohet se me rastin e shitblerjes kan perpiluar ndonje kontrat me shkrim por marreveshja ka qene gojore. E di se me rastin e blerjes ne ate paluajteshmeri nuk ka pas shtepi te ndertuar mirepo pas nje viti te njejtia kane maruar shtepi secili njekateshe. Secili e ka te rrethuar paluajteshmerin e vet dikush me gardh e dikush prej murit prej bllokave. E di se prej kur e kan blere kete paluajteshmeri e kane shfrytezuar dhe poseduar pa kurrfar pengesash nga askush dhe une nuk e di se dikush ka pas ndonje kundershtrim lidhur me kete paluajteshmeri.. Keto rrethana me jane te njohura pasi qe une jetoj ne fqinjesi me paditesit

Ne nje gjendje te ketille faktike te cekur me lart, gjykata erdhi ne perfudim dhe konstatoi se patundshmerit tani lendore i kane blere paraardhesit (baballaret e paditesve) , ne baze te marreveshjes gojore ne vitin 1971, dhe se qmimin e shiteblerjes, shitesit ia kane paguar ne tersi, te cilat paluajteshmeri shitesi menjeher u'a ka lene ne disponim dhe shrytezim te lire te njejtat paraardhesve te paditesve – e tani paditesve te cilit se bashku me anetaret e familjes se tyre e kane shfrytezuar pa pengesa qe nga momenti i shitberjes, e tani e tutje e shfrytezojne.

Ne baze te nenit 28 p 4 te LMTHJP eshte percaktuar se: Mbajtesi me mirebesim I sendit te paluejtshem , mbi te cilin tjetri ka te drejten e pronsise, fiton te drejten e pronsise mbi kete send me parashkrimin fitues me kalimin e kohes prej 20 (njezet) vjetesh.

Ne rastin konkret nga momenti i shitblerjes, paraardhesit e paditesve , e tani paditesit e kane pasur ne shfrytezim dhe disponim te lire keto paluajteshmeri dhe ate: me mirebesim dhe pa pengesa nga askush, andaj ne anen e paditesve ekzistojne te gjitha bazat ligjore per fitimin e pronsise ne baze te mbajtjes e keto jane: mbajtja me mirebesim, koha e nevojshme si dhe shfrytezimi i papengueshem i ketyre paluajteshmerive.



Mbajtja me mirebesim ekziston nga se paraardhesit (baballaret) e paditsve keto paluajtshmeri i kane blere nga shitesi

Koha e nevojshme mbi 20 (njetzet) vite, ekziston nga se paraardhesit (baballaret) e paditsve keto paluajtshmeri i kane blere nga shitesi - i padituri, qysh nga viti 1971.

Gjithashtu nga momenti i shitblerjes, paraardhesit e paditsive e tani edhe paditesit kane hyre ne posedim dhe shfrytezim te lire dhe te papengueshem te ketyre paluajtshmerive te tyre, e gjere me tani.

Andaj, gjykata konkludon, se ne rastin konkret kemi te bejme me fitimin e pronesise nga ana e paditesvet me mbajtje, konform nenit 28 p 4 te LMTHJP.

Gjykata ne kete rast i aplikoi dispozitat e LMTHJP, nga se raporti juridik konkret i qeshtjes kontestimore eshte sajuar ne kohen kur ne aplikim ka qene ligji i lartecekur.

Vendimi mbi shpenzimet e procedures kontestimore, bazaohet ne baze te nenit 450 dhe 459 te LPK-es.

Nga te cekurat me lart u vendos si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE
C.nr.265/2012, dt.24.04.2015.

REPUBLIKA E KOSOVES  REPUBLIKA KOSOVA

VENDMI ESHTË I PLOTFUQISHËM
 DDLUKA JE PRAYNOSNAZNA
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
 MITROVICE - MITROVICA

Gjyqtari,
 Skender Shala

M/e
 Dat:

14.05.2015

KESHILLE JURIDIKE: Kunder ketij aktgjykimi eshte e lejuar ankesa, ne afat prej 15 (pesembedhjet) diteve, nga dita e pranimit, Gjykates se Apelit ne Prishtine, e permes kesaj gjykate.



Saktesin e pershkrimit e verteton: